



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK**

Nr. 6002/1 Prot.

Korçë, 14.09.2023

Lënda: Informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për PBA 2024-2026 gjatë fazës së parë

**DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 21 datë 7.7.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, po ju paraqesim informacionin mbi rekomandimet e MFE për PBA 2024-2026 faza e parë, si më poshtë:

Rekomandimet:

- I. Bashkia të mbajë në konsideratë se këta tregues duhet: a) të përfaqësojnë politikën kombëtare/standartin kombëtar; b) të jenë të matshëm; c) të ekzistojnë të dhëna historike; ose mund të ndërtohen baza të dhënash lehtësisht; d) të japin sa më mirë performancën e shërbimit që prodhon programi; f) të jenë të thjeshtë; pra të mund të raportohet tek Këshilli bashkiak dhe komuniteti:

Projekt Buxheti Afatmesëm 2024-2026 është përgatitur mbi planin e përgjithshëm vendor 2016-2031, mbi kuadrin makroekonomik fiskal 2024-2026, mbi udhëzimet e dërguara nga MFE dhe sipas Instrumentit të Planifikimi Financiar, i cili jep informacion të detajuar mbi qëllimet, objektivat, politikat etj.

- II. Janë përdorur edhe produkte të tjera të cilat nuk janë pjesë e listës së miratuar me udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë:

Bashkia Korçë, si bashki pilot në përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetin e vitit 2023, ka bërë një planifikim të buxhetit në nivel produkti. Këto produkte janë marrë për bazë edhe në përgatitjen e PBA 2024-2026. Në lidhje me këtë koment, Bashkia Korçë mendon se ka respektuar plotësisht udhëzimet e MFE për metodologjinë e re.

Në Shtojcën 5 të Udhëzimit Nr. 6, datë 28.02.2023 për Përgatitjen e PBA Vendor 2024-2026, MFE ka përfshirë gjithashtu (shprehimisht) një **Listë Orientuese** të Produkteve Standarte sipas funksioneve vendore për nëntë NJVQV që ndjekin metodologjinë e re të buxhetimit. Gjithashtu, në Instrumentin e Planifikimit Financiar të dërguar nga MFE për bashkitë që ndjekin metodologjinë e re të buxhetimit, hapësira prej 6 produktesh për cdo objektivi është ndarë përkatësisht: në 3 produkte (ngjyrë të gjelbër) e dedikuar për Produktet Standarde sipas Shtojcës 5; 1 produkt (ngjyrë portokalli) për projektet ekzistuese; dhe, 2 produkte (ngjyre bojeqielli) për produkte të reja. Pikërisht këtë hapësirë me ngjyrë bojeqielli Bashkia Korçë e ka përdorur për të

prezantuar produktet shtesë që nuk janë pjesë e listës **orientuese** të produkteve standarde, por që janë pjesë e produkteve që Bashkia Korçë po përdor në zbatimin e buxhetit 2023 në SIFQ.

III. Rekomandojmë që në fazën e dytë të plotësohen treguesit e performancës për çdo program në nivel qëllimi dhe objektivi.

Në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026 janë plotësuar treguesit e performancës për çdo program në nivel qëllimi dhe objektivi dhe është bërë rishikimi i tyre në fazën e dytë.

IV. Rekomandojmë që në procesin e PBA të përfshihen të gjithë drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe anëtarët e çdo programi për të përcaktuar me saktësi tavanet e programit, përshkrimin e politikës, qëllimin, produktet, lidhjen e secilit produkt me një objektivi të caktuar:

Theksojmë se në procesin e PBA janë përfshirë të gjithë drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe anëtarët e çdo programi.

V. Bashkia Korçë duhet të rishikojë tabelën e investimeve sipas programeve, pasi shuma totale për vitet 2024-2026 (tabela 8), nuk përputhet me formatin e “shpenzimeve totale të bashkisë sipas kategorive ekonomike”, si rrjedhojë duhet rishikuar ky format në fazën e dytë të PBA-së:

Investimet e planifikuara në PBA 2024-2026 janë planifikuar dhe përshtatur sipas formateve të përcaktuara nga MFE. Pra tabela 8 përmban të gjitha projektet e investimeve të përcaktuara me **(P, projekt)**, në Instrumentin e Planifikimit Financiar, kurse shpenzime kapitale të tilla si: paisje për mirëmbajtjen e infrastrukturës, mbikqyrje, kolaudime, paisje elektronike, etj., janë të përcaktuara me **(V. Produktet Operacionale (jo-projekte))**. Kjo është arsyeja përse këto tabela nuk përputhen.

VI. Rekomandojmë që në periudhën afatmesme shpenzimet operative të jenë të qëndrueshme dhe në rënie të vazhdueshme në funksion të rritjes së investimeve, si dhe të synohet ulja e nivelit të shpenzimeve të personelit në mënyrë që të rritet efënca e ofrimit të shërbimeve: Theksojmë se në PBA 2024-2026 shpenzimet operative (këtu janë të përfshira edhe shërbimet: si shërbimi i pastrimit, shërbimi urban, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave, aktivitete në fushën e turizmit dhe inovacionit, etj.) janë të qëndrueshme dhe në shërbim të qytetarëve. Përsa i përket shpenzimeve të personelit ato janë planifikuar sipas VKM për përcaktimin e pagave. Cilësia e ofrimit të shërbimeve në Bashkinë Korçë është në rritje. Bashkia Korçë është cilësuar si një ndër qytetet më të pastra, ka zhvillim ekonomik, stabilitet social, mundësi kulturore dhe argëtimi. Bashkia ka orientuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit, shtresave në nevojë, çerdhe, kopshte, shkolla, qendra për moshën e tretë, duke i qëndruar kështu më pranë nevojave të banorëve. Zhvillimi i turizmit në këto vite ka qenë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i Zhvillimit ekonomik për Korçën, kështu që do të vijojë të jetë në vëmendjen tonë edhe për vitet 2024-2026.

Ju faleminderit për bashkëpunimin

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq Filo**

